



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria -Vlada-Government*

## **STRATEGJIA**

**KUNDËR FALSIFIKIMIT DHE PIRATERISË  
2012 – 2016**

## Përmbajtja

1. Strategjia.....	6
1.1. Përmbledhje Ekzekutive .....	6
1.2. Hyrje.....	7
1.3. Metodologjia.....	8
1.4. Sfondi .....	9
1. Nocionet e përgjithshme .....	10
1.1. E Drejta e Autorit .....	10
2.1.2. Veprat e mbrojtura .....	11
2.1.3. Krijimet pa mbrojtje .....	11
2.1.3. Pirateria .....	12
3. Infrastruktura ligjore.....	13
3.1. Ligjet.....	13
3.2. Aktet nënligjore .....	13
3.3. Legjislacioni Evropian dhe Ndërkombëtar.....	14
4. Mjetet juridike .....	15
4.1. Ligji mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta .....	15
4.1.2. Dispozitat ndëshkuese.....	15
4.2. Kodi Penal i Kosovës .....	16
5. Rolet dhe Përgjegjësitë e Institucioneve .....	17
5.1. Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta .....	17
5.2. Inspektorati i Tregut .....	18
5.3. Policia e Kosovës .....	18
5.4. Dogana e Kosovës .....	19
5.5. Zyra për Pronësi Industriale.....	19

5.6.	Ministria e Drejtësisë.....	20
5.7.	Oda Ekonomike e Kosovës.....	20
5.8.	Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë .....	21
5.9.	Universiteti i Prishtinës .....	22
5.10.	Komisioni i Pavarur për Media.....	22
5.11.	Shoqatat për Administrim Kolektiv .....	23
6.	Qëllimi, objektivat dhe aktivitetet e strategjisë.....	24
6.1.	Qëllimi .....	24
6.2.	Objektivat .....	24
6.3.	Aktivitetet dhe Alternativat e konsideruara .....	25
7.	Qasja e rekomanduar dhe hapat e ardhshëm për zbatimin e strategjisë.....	26
7.1.	Qasja e Rekomanduar .....	26
7.2.	Misioni i Task Forcës .....	27
8.	Plani i Veprimit dhe objektivat.....	28
8.1.	Realizimi .....	28
8.2.	Objektiva 1: Ulja e nivelit të piraterisë dhe falsifikimit .....	28
8.3.	Objektiva 2: Rritja e produktivitetit në industrinë kreative .....	29
8.4.	Objektiva 3: Identifikimi i problemeve dhe shkaqeve që ndikojnë në rritjen e piraterisë dhe falsifikimit.....	30
8.5.	Objektiva 4: Luftimin e ekonomisë joformale dhe krijimi i parakushteve për investime të huaja.....	31
8.6.	Objektiva 5: Bashkëpunimi ndërinstitucional në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.....	32
8.7.	Objektiva 6: Arritja e standardeve evropiane.....	33

**Grupi Punues Ndërministror**

1.	Feim Maliqaj-Kryesues	Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta/ ZDA-MKRS
2.	Genc Prelvukaj	Kabineti i Ministrit
3.	Valon Kashtanjeva	Zyrtar i Lartë në ZDA-MKRS
4.	Shkelzen Nuza	Menaxher i Teknologjisë Informative në MKRS
5.	Veli Hoti	Zyrtar i Lartë, Zyra për Pronësi Industriale /ZPI-MTI
6.	Ruzhdi Shehu	Inspektorati i Tregut-MTI
7.	Elhami Shaqiri	Zyra për Planifikim Strategjik-ZKM
8.	Selvije Elezaj	Ministria e Drejtësisë-MD
9.	Esat Mazreku	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë-MASHT
10.	Shaip Havolli	Policia e Kosovës - PK
11.	Sadije Topojani	Dogana e Kosovës - DK
12.	Lumnije Hashani	Oda Ekonomike e Kosovës
13.	Niman Racaj	Komisioni i Pavarur për Media-KPM
14.	Florent Boshnjaku	APIK
15.	Blerim Gjoci	VAPIK
16.	Gregor Stibernik	Ekspert
17.	Borut Bernik Bogataj	Ekspert

## STRATEGJIA KUNDER FALSIFIKIMIT DHE PIRATERISE

**Shkurtesat**

<b>ZDA</b>	Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta
<b>ZPI</b>	Zyra për Pronësi Industriale
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>DK</b>	Dogana e Kosovës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>MKRS</b>	Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sportit
<b>MTI</b>	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>PI</b>	Pronësi intelektuale
<b>IT</b>	Teknologjia e informacionit
<b>KPM</b>	Komisioni I Pavarur për Media
<b>MIE</b>	Ministria e Integriteteve Evropiane
<b>TRIPS</b>	Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale
<b>ËIPO</b>	Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale
<b>APIK</b>	Shoqata e Administrimit Kolektiv
<b>VAPIK</b>	Shoqata e Administrimit Kolektiv
<b>OEK</b>	Oda Ekonomike e Kosovës

## 1. Strategjia

### 1.1. Përmbledhje Ekzekutive

Falsifikimi dhe pirateria janë veprime të cilat janë të ndaluara me ligjet pozitive në Kosovë. Sidoqoftë, deri më tani nuk janë marrë veprime konkrete në luftimin e këtyre dy dukurive të cilat ndikojnë në ekonominë e tregut dhe zhvillimin ekonomik. Duke parë që të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta janë të garantuara me Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta në Kosovë dhe se cenimi i këtyre të drejtave paraqet vepër penale me të cilat janë parapare dispozitat ndëshkuese atëherë Qeveria e Kosovës konsideron se është e nevojshme hartimi i kësaj strategjie me të cilën do të sigurohej luftimi i piraterisë dhe luftimi e parandalimi i falsifikimit të produkteve në treg, të mbrojtura me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Në këtë strategji si objektiva kryesore janë identifikuar: Ulja e nivelit të piraterisë dhe falsifikimit; Rritja e produktivitetit në industrinë kreative; Identifikimi i problemeve dhe shkaqeve që ndikojnë në rritjen e piraterisë dhe falsifikimit; Luftimin e ekonomisë joformale dhe krijimi i parakushteve për investime të huaja; Bashkëpunimi ndërinstytucional në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe Arritja e standardeve Evropiane.

Aktivitetet e parapara për përmbushjen e kësaj strategjie janë: plotësimi dhe zbatimi i legjislacionit aktual, fuqizimi i institucioneve përgjegjëse dhe krijimi i institucioneve tjera të nevojshme; Krijimi i mekanizmave institucional dhe funksionalizimi i atyre ekzistues- themelimi i Task Forcës; Identifikimi i produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit; Krijimi i sistemit të menaxhimit të informacionit nga institucionet përgjegjëse; Sensibilizimi i opinionit me të drejtat e autorit, organizimi i fushatave senzibilizuese; Konfiskimi i materialeve pirate dhe të falsifikuara; Sekuestrimin e materialeve të dyshuara për shkelje të drejtës së autorit; Organizimi i anketave dhe hulumtimeve; Përpilimi i raporteve në bashkëpunim me organet e rendit dhe drejtësisë respektimin e të drejtës së autorit; Pajisja me etiketa/bar-kode e produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit; Pajisja me autorizime të prodhuesve për pikat e shitjes të produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit, me rastin e regjistrimit të bizneseve; Parandalimi i krimit të organizuar në fushën e piraterisë dhe falsifikimit; Rregullimi i procedurave të vënies së produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit në treg; Takimet e rregullta të Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale; Themelimi i Task Forcës; Shkëmbimi më shpeshtë i informative; Nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit me institucionet përkatëse; Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare; Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit rajonal; Shkëmbimi i përvojave me vendet e rajonit; Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit vendor me atë Evropian si dhe Aplikimi i përvojave dhe metodave më efikase të përafërta me rajonin në luftën kundër falsifikimit dhe piraterisë.

Përpilimi i kësaj strategjie është parë tejet e nevojshme, duke pasur parasysh faktin që në tregun e Kosovës ekzistojnë shumë mallra të falsifikuara si CD, DVD, dhe qendra të fotokopjimit të cilat në mënyrë drastike bëjnë shkeljen e të drejtave të autorit me Ligjin mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Për më tepër, me anë të kësaj strategjie dhe themelimit të Task Forcës, do të merren veprime konkrete në luftimin e ekonomisë jo formale. Në këtë mënyrë, krijuesit, do të inkurajohen që të krijojnë më

shumë vepra pasi që do të jenë të siguruar që kreativiteti i tyre do të shpërblehet.

## 1.2. Hyrje

Çështja e luftimit të falsifikimit dhe piraterisë në të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta është sfidë jo vetëm e Qeverisë së Kosovës por edhe e vendeve tjera të zhvilluara. Kjo për shkak se çdo ditë e më shuma teknologjia informative po ndikon në zhvillimin e shoqërisë, por dhe po krijohen mundësi të shumta të keqpërdorimit të këtyre avancimeve.

Si kategori e së drejtës, e drejta e autorit është e kodifikuar më se tre shekuj dhe është zhvilluar në hap me zhvillimet më të mëdha shoqërore-ekonomike në botë. E drejta e autorit është e garantuar me ligje nacionale dhe me një mori direktivash, konventash e traktatesh shumë të rëndësishme ndërkombëtare. Për më tepër, e drejta e autorit gjen mbrojtje në njërën nga dokumentet më të rëndësishme të të drejtave të njeriut në botë, ajo është e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Neni 27 i Deklaratës parasheh se çdokush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilës është ai vet.

Në ditët e sotme, e drejta e autorit ka marrë një hov të madh të zhvillimit dhe atë falë vrullit të krijimtarisë, e sidomos asaj në internet. Me zhvillimet e tanishme teknologjike, është bërë shumë më e lehtë të krijohet në të gjitha fushat ku krijimtaria shkencore, artistike letrare mund të gjejë aplikim. Mirëpo, ana tjetër e medaljes tregon faktin e rritjes se mundësive për ta cenuar të drejtën e autorit, përmes piraterisë on-line, plagjiaturës përmes vjedhjes së krijimeve origjinale dhe paraqitjen e tyre me pasive pra autentike në mënyrë të paligjshme. Fatkeqësisht, në Kosovë, shkalla e piraterisë dhe falsifikimit është shumë e lartë. Nga një raport zyrtar i ZDA-së thuhet se niveli i piraterisë dhe falsifikimit të produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit, jo vetëm që arrin, por edhe tejkalon pragun më të lartë të piraterisë dhe se situata në këtë fushë është jashtë çdo kontrolli institucional.

Dukuria e falsifikimit dhe piraterisë është pikërisht një nga deformimet e evidentuara të tregut përbrenda Republikës së Kosovës. Në krahasim me rajonin, angazhimi për të stabilizuar gjendjen e komunitetit krijues, vendi nuk është në linjë të njëjtë. Përveç angazhimit vetjak, të rrallë e jo të frytshëm të sektorit privat, industritë kreative nuk kane pasur përfitim nga ndonjë ndërhyrje e organizuar shtetërore drejt përmirësimit të tregut.

Për këtë arsye organizimi i një grupi qeveritar, me detyrë të veçantë, nga komuniteti i prekur shihet si e vetmja zgjidhje drejt përmirësimit të kushteve të tyre për punë. Ndërhyrja për të mënjeluar piraterinë si dukuri, ndikon në përmirësimin po ashtu të pozicionit shtetëror në ballë të mekanizmave ndërkombëtarë. Në Raportin e Progresit, të vitit të kaluar, Republika e Kosovës është vënë në shënjestër për shkak të mungesës së angazhimit efikas kundër falsifikimit që nënkupton në mënyrë sistematike edhe mbrojtjen e të drejtave të autorit. Po ashtu edhe ndihma e dhënë ndaj komunitetit krijues me rastin e përmirësimit të kushteve për punë ndikon në rritjen e cilësisë së krijimeve dhe angazhimeve promovionale që ndikon në ndërtimin e një pasqyre shumë më të mirë

kundrejt vendeve të zhvilluara meqenëse arti, shkenca dhe letërsia përbëjnë ndoshta celulën më të rëndësishme të përfaqësimit ndërkombëtar.

Qëllimi kryesor i hartimit të kësaj strategjie, veç interesave tjera të prekura tërthorazi më lartë, është edhe ndriçimi i përfitimeve shtetërore nga pastrimi i tregut nga devijimi i tillë në aspektin ekonomik. Pirateria është pjesë e ekonomisë joformale, që nuk i nënshtrohet asnjë takse shtetërore dhe paraqitet si rrugë efikase drejt pasurimit të paligjshëm të personave të caktuar në kurriz të krijuesve dhe të vetë shtetit. Me konsultimin edhe të organizatave ekonomike si dhe ekspertëve të fushës konstatohet se luftimi i piraterisë ndikon në të hyrat e shtetit duke pasuruar thesarin buxhetor.

Kjo strategji ndërlidhet edhe me ekonominë e Kosovës pasi që nga luftimi i piraterisë, Kosova mund të përfitojë edhe mjaft të ardhura. Një ndërlidhje tjetër e strategjisë mund të jetë edhe ndërlidhja me agjendën evropiane

### 1.3. Metodologjia

Në bazë të vendimit nr. 976 /2012, të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 04/07/2012, është themeluar Grupi Punues Ndërmënyorë për hartimin e strategjisë kundër falsifikimit dhe piraterisë. Ky Grup Punues përbëhet nga institucionet të cilat janë të obliguar të zbatojnë dhe mbrojnë të drejtat e pronësisë intelektuale në Kosovë. Në grupin punues janë të përfshirë edhe dy shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në Kosovë. Për hartimin e kësaj strategjie janë bërë konsultime me ekspertë të jashtëm nga Sllovenia dhe Hungaria.

Institucionet e angazhuara në këtë Grup Punues: MKRS/ZDA, MTI/ZPI, MTI/Inspektorati i Tregut, MASHT, MPB/Policia e Kosovës, MF/Dogana e Kosovës, MF/Administrata Tatimore e Kosovës, Komisioni i Pavarur i Medieve, Ministria e Drejtësisë, Oda Ekonomike e Kosovës.

Për hartimin e kësaj strategjie janë përdorur metodat hulumtuese, krahasimore dhe analitike.

ZDA, në procesin e parapërgatitjeve për hartimin e strategjisë ka realizuar një numër të takimeve me palët e interesuara, përkatësisht ka takuar grupet e ndryshme të titullarëve të të drejtave, dhe në anën tjetër ka takuar edhe përfaqësues të grupeve të shfrytëzuesve të të drejtave. Grupit punues gjatë hartimit të strategjisë ka konsultuar legjislacionin vendor dhe ndërkombëtarë.

Në kuadër të legjislacionit ndërkombëtar janë konsultuar traktatet dhe konventat ndërkombëtare (Konventa e Bernës, Marrëveshja TRIPS); nga legjislacioni BE-së, janë konsultuar rregulloret dhe direktivat e Unionit Evropian; ndërsa në kuadër të legjislacionit vendor janë konsultuar ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, duke përfshirë dhe Kodin Penal.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Shih Kapitullin "Infrastruktura Ligjore



Në të njëjtën kohë është bërë krahasimi i përvojave të vendeve të rajonit me praktikën e luftës kundër piraterisë dhe falsifikimit. Për më tepër janë studiuar masat parandaluese dhe dispozitat ndëshkuese kundrejt kryesve të këtyre shkeljeve.

Pas analizimit të informacioneve të mbledhura nga ZDA, në takimet me titullarët dhe mbajtësit e të drejtave, konsultimit të legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtarë, dhe i këshilluar nga ana e ekspertëve të lartë përmendur, grupi punues për hartimin e strategjisë, paraqet këtë dokument strategjik.

#### 1.4. Sfondi

Me anë të kësaj strategjie trajtohet problemi i falsifikimit dhe piraterisë në të drejtën e autorit. Problem ky i cili është zhvilluar viteve të fundit në Republikën e Kosovës. Në territorin e Kosovës, ne pikat e ndryshme të shitjes gjenden materiale pirate, të cilat janë prodhuar në mënyrë të paligjshme, përkatësisht duke shkelur të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të përfaqësuara. Shitja dhe prodhimi i këtyre materialëve pirate është duke e dëmtuar rëndë industrinë kreative në Kosovë. Respektivisht kanë ndikuar negativisht në fushën e kreativitetit, duke zvogëluar nxitjet për krijime të reja dhe duke i ofruar publikut materiale jo kualitative dhe të dëmshme. Kjo manifestohet përmes shitjes së materialeve pirate, në formë të librave, CD-ve me përmbajtje muzikore, filmike, programeve kompjuterike, programeve edukative etj.

Në vendin tonë, materialet pirate paraqiten në formë e fizike dhe elektronike. Për dallim me vendet e rajonit të cilat kanë luftuar më me efikasitet piraterinë fizike, dhe janë duke ndërmarrë masa kundër piraterisë në internet, në Kosovë, dy format e piraterisë janë intensivisht prezentë, dhe nuk ka pasur deri më tani ndonjë ndërhyrje të organizuar institucionale. Për më tepër, në vendet e rajonit, ky mbajtësit e të drejtave, kanë filluar procedura ligjore ndaj prodhuesve, shpërndarësve dhe shitësve të produkteve kreative pirate, në Kosovë, nuk ka të dhëna mbi procedurat ligjore të filluara kundër të njëjtëve. Ky fakt e bënë edhe më të domosdoshëm intervenimin e organizuar shtetërorë, përkatësisht hartimin e kësaj strategjie.

Në kontekst të faktorëve të cilët kanë ndikuar në masë të konsiderueshme në problemin e falsifikimit dhe piraterisë, janë; në radhë të parë mos ekzistimi i legjislacionit adekuat për këtë fushë, deri në momentin e nxjerrjes së ligjit të parë për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në vitin 2006. Dhe më pas, mos përdorimi i këtij ligji nga titullarët e të drejtave kundrejt shkelësve potencial. Me nxjerrjen e ligjit të ri për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta më 30 Nëntor 2011, Kosova për herë të parë ka një ligj i cili është në harmoni me legjislacionin ndërkombëtarë dhe evropian . Nga hulumtimet të cilat ka realizuar ZDA, mbajtësit e të drejtave nuk janë duke shfrytëzuar legjislacionin në fuqi kundër shkelësve të të drejtave, dhe kjo ka ndikuar që fenomeni i piraterisë dhe falsifikimit të zhvillohet edhe më tepër.

Kundër dukurisë së falsifikimit dhe piraterisë, në kuadër të masave të përgjithshme për forcimin e të drejtës së autorit në Kosovë, është realizuar fushata për vetëdijesimin e qytetarëve për drejtën e autorit. Por edhe nga ana Komisionit Evropian janë duke u realizuar projekte për forcimin e pronësisë intelektuale, dhe në këtë kontekst edhe të

drejtës së autorit. Përfundimisht, në Kosovë, nuk ka ndonjë aktivitet ekzistues që ka për qëllim zgjidhjen e problemit, përkatësisht të falsifikimit dhe piraterisë.

## 1. Nocionet e përgjithshme

### 2.1. E Drejta e Autorit

E drejta e autorit<sup>2</sup> është pjesë e degës së të drejtës e cila merret me të drejtat intelektuale të krijuesve. E drejta e autorit në veçanti merret me format e kreativitetit, duke i kushtuar rëndësi komunikimit masiv. Po ashtu merret me të gjitha format dhe metodat e publikimit, komunikimit, jo vetëm për publikimet e printuara por po ashtu edhe për çështje të tilla si, zëri dhe transmetimi televiziv, filmat që paraqiten në kinema, etj, për më tepër edhe sistemet e kompjuterizuara për ruajtjen dhe rikthimin e informacionit.

E drejta e autorit merret me të drejtat e krijuesve në krijimet e tyre. Shumica e veprave, për shembull, librat, pikturat ose vizatimet, ekzistojnë vetëm kur të jenë paraqitur në një objekt fizik. Por disa nga ato ekzistojnë edhe pa u paraqitur në ndonjë objekt fizik, për shembull, veprat muzikore dhe poezitë ekzistojnë edhe nëse nuk janë, ose para se të jenë shkruar në nota muzikore ose fjalë.

E drejta e autorit nuk mbron idetë, por mbron vetëm shprehjen e ideve. Kreativiteti i mbrojtur me të drejtën e autorit, është kreativiteti në zgjidhjen dhe aranzhimin e fjalëve, notave muzikore, ngjyrës, formës dhe të tjera. E drejta e autorit mbron të drejtat e pronarit në veprat artistike kundër atyre që “kopjojnë”, kjo nënkupton, ata që e marrin dhe përdorin formën në të cilën vepra origjinale është shprehur nga autori.

Titullari i së drejtës së autorit gëzon të drejtën të autorizojë dhe ndalojë veprime të caktuara në lidhje me veprën e tij të mbrojtur. Në këtë kontekst, titullari mund të ndalojë ose autorizojë riprodhimin e veprës në forma të ndryshme, siç janë publikimet e printuara dhe regjistrimet e tingujve; shpërndarjen e kopjeve; shfaqjen në publik; transmetimin e tyre ose çdo komunikim tjetër në publik; përkthimin e saj në gjuhë tjetër; përshtatjen, si p.sh një novelë në skenar, etj.

Ndërsa, në Kosovë sipas Ligjit mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, rregullohen të drejtat autorëve përkitazi me veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit, si dhe të drejtat që në bazë të pronësisë intelektuale janë të përafërta me të drejtat e autorit (të drejtat e interpretuesve përkitazi me interpretimet e tyre; prodhuesve të fonogrameve përkitazi me fonogramet e tyre; producentëve të filmit përkitazi me videogramet e tyre; shërbyesit medial Audio-vizual përkitazi me transmetimet e tyre; prodhuesve të bazave të të dhënave përkitazi me bazat e tyre të të dhënave; botuesve përkitazi me botimet e tyre). Për më tepër, ky ligj rregullon dhe administrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta dhe siguron zbatimin e këtij ligji ndaj personave të huaj.

---

<sup>2</sup> Sipas definicionit të bërë nga Organizata Botërore për Pronësi Intelektuale  
[http://ëëë.ëipo.int/export/sites/ëëë/about-ip/en/iprm/pdf/ip\\_handbook.pdf](http://ëëë.ëipo.int/export/sites/ëëë/about-ip/en/iprm/pdf/ip_handbook.pdf)

E drejta e autorit është e drejtë e pandashme e një vepre, e cila i takon autorit si subjekt i pronës intelektuale për veprën e mbrojtur. Në kuadër të të drejtave të autorit hyjnë, autorizimet ekskluzive personale për të mbrojtur pacenueshmërinë e veprës së autorit dhe personalitetin e autorit – që ndryshe njihen si të të drejtat morale të autorit dhe autorizimet ekskluzive pasurore për të mbrojtur interesat pasurore të autorit – të drejtat pasurore ose ekonomike të autorit.

Autorët e veprave në lëmin e letërsisë, shkencës dhe të artit gëzojnë mbrojtjen lidhur me veprat e veta dhe shfrytëzimin e tyre, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

### 2.1.2. Veprat e mbrojtura

Sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë, vepra të mbrojtura janë krijimet intelektuale origjinale në lëmin e letërsisë, të shkencës dhe artit, pavarësisht mënyrës se si janë të shprehura.<sup>3</sup> Vepra të autorit konsiderohen në veçanti:

- Veprat gojore, siç janë fjalimet, leksionet, tregimet dhe vepra të ngjashme të shprehura gojarisht;
- Veprat e shkruara, siç janë tekstet në libra, broshurat, gazetat ditore dhe tekste të tjera në lëmin e letërsisë, literaturës shkencore e profesionale, si dhe programe kompjuterike;
- Veprat muzikore, me ose pa tekst, pavarësisht a janë të shprehura përmes notave apo në ndonjë formë tjetër;
- Veprat teatrore teatrore-muzikore dhe të kukullave, përfshirë dhe radiodramat;
- Veprat koreografike dhe të pantomimës;
- Veprat filmike dhe veprat e tjera audio-vizuale;
- Veprat fotografike dhe veprat e bëra me një proces të ngjashëm si ai i fotografisë, siç janë fotografitë artistike, fotomontazhet, foto-afishet, fotografitë e reporterëve;
- Veprat e artit figurativ në lëmin e pikturës, skulpturës, grafikës, vizatimit;
- Veprat e arkitekturës, siç janë skicat, planet, maketat dhe objektet e ndërtuara të veprave arkitekturore dhe të inxhinierisë nga fusha e arkitekturës, urbanizmit, arkitekturës së peizazhit dhe rregullimit të enterierit;
- Veprat skenografike;
- Veprat e artit aplikativ si dhe të dizajnit industrial e grafik;
- Veprat kartografike në lëmin e gjeografisë dhe topografisë;
- Prezantimet shkencore, edukative ose teknike siç janë vizatimet teknike, grafikonet, tabelat, ekspertizat, demonstrimet tredimensionale.

### 2.1.3. Krijimet pa mbrojtje

---

<sup>3</sup> Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, Ligji Nr. 04/L-065, Neni 8, Veprat e Mbrojtura.

Ndërsa krijimet të cilat nuk gëzojnë mbrojtje juridike në të drejtën e autorit sipas legjislacionit tonë janë:<sup>4</sup>

- Idetë, parimet, udhëzimet, procedurat, zbulimet ose konceptet matematikore si të tilla.
- Ligjet, aktet nënligjore dhe rregullativat tjera.
- Materialet zyrtare dhe botimet e organeve parlamentare, qeveritare dhe të organizatave tjera që kryejnë funksione publike.
- Përktimet zyrtare të rregullativave dhe materialeve tjera zyrtare, si dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe instrumenteve tjera.
- Parashtresat dhe aktet tjera në procedurat administrative ose gjyqësore.
- Materialet zyrtare të botuara për informim të publikut.
- Shprehjet folklorike.
- Lajmet e ditës dhe informacionet e ndryshme që kanë karakter të raportimeve të rëndomta të medie.

### 2.1.3. Pirateria

Termi pirateri është i definuar në mënyra të ndryshme, varësisht nga shteti dhe konteksti i përdorimit.<sup>5</sup> Pirateria si term, dhe definicion nuk është e përfshirë në legjislacionet vendore të shteteve, mirë po, pirateria është definuar vetëm në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare.<sup>6</sup>

Pirateria, përfshinë reproduktimin dhe shpërndarjen, e kopjeve të mbrojtura me të drejtën e autorit, apo komunikimin dhe vënien në dispozicion të materialit të mbrojtur në internet, pa autorizim paraprak nga titullari i së drejtës, kur autorizimi i tillë është i nevojshëm në bazë të ligjit.<sup>7</sup>

Në këtë kontekst, duhet potencuar fakti, se nocioni i piraterisë nuk është i definuar me legjislacionin tonë vendor, dhe për këtë arsye kjo strategji përdorë definicionin ligjor ndërkombëtarë, përkatësisht definicionin e interpretuar në marrëveshjen Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelktuale (TRIPS), konkretisht shënimit 14, për interpretimin e termit të përdorur në nenin 51 të marrëveshjes,<sup>8</sup> sipas së cilës kemi këtë definicion: Materiale pirate, janë materiale kopje te produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit, të prodhuara, pa lejen paraprake e titullarit të së drejtës, e që konstituon shkelje te një të

<sup>4</sup> Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, Ligji Nr. 04/L-065, Neni 12, Krijimet pa Mbrojtje

<sup>5</sup> Organizata Ndërkombëtare e Pronësisë Intelktuale, A ekzistojnë definicione të pranura ndërkombëtare lidhur me piraterinë? Më 08.01.2012, <http://ëëë.ipo.int/enforcement/en/faq/counterfeiting/faq01.html>

<sup>6</sup> UNESCO, “Çka është pirateria”. Më 20.07.2012, [http://portal.unesco.org/culture/en/ev.php-URL\\_ID=39397&URL\\_DO=DO\\_TOPIC&URL\\_SECTION=201.html](http://portal.unesco.org/culture/en/ev.php-URL_ID=39397&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html)

<sup>7</sup> UNESCO, “Çka është pirateria”. Më 20.07.2012, [http://portal.unesco.org/culture/en/ev.php-URL\\_ID=39397&URL\\_DO=DO\\_TOPIC&URL\\_SECTION=201.html](http://portal.unesco.org/culture/en/ev.php-URL_ID=39397&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html)

<sup>8</sup> Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelktuale (TRIPS), neni 51, shih shënimin 14, interpretim lidhur me nocionin e piraterisë, i paraqitur në formë te fusnotës.

drejte të autorit apo te drejte të përafërte. Definicioni, për më tepër ka edhe elementin e qarkullimit tregtar të materialit nga një vend, në tjetrin, konkretisht nga vendi i prodhimit në vendin e importimit, element ky që nuk është objekt i strategjisë.

Në bazë të definicionit të përdorur në TRIPS, interpretim ky i pranuar ndërkombëtarisht, mund të nxirret në përfundim, se edhe pse pirateria, nuk është e sanksionuar me legjislacionin tonë, veprimet me të cilat kryhen shkeljet e së drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërt, të bëra me qëllim dhe në shkallë komerciale, paraqesin veprime pirate dhe janë të ndaluara, konform dispozitave të Ligjit mbi të drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta; të Kodit Penal të Kosovës. Legjislacioni vendor, parashih masa civile-juridike, e me Kodin Penal, parashihen edhe sanksione penale për të gjithë shkelësit e të drejtave të autorit.

Pirateria, është dukuri që ka të bëjë me shkeljet e të drejtave, për veprat të ndryshme; si veprat muzikore, letrare, filmike, programeve kompjuterike, video lojërave, bazës së të dhënave etj, të gjitha të mbrojtura me Ligjin për të drejta e Autorit dhe drejtat e përafërta.

### 3. Infrastruktura ligjore

#### 3.1. Ligjet

Legjislacioni në fuqi, me anë të së cilit mbrohen dhe zbatohen të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, në Republikën e Kosovës:

- Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta - Nr. 04/L-065
- Ligji për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale - Nr. 03/L-170
- Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimeve kibernetike, Ligji Nr. 03/L-166
- Ligji për investimet e huaja - Nr. 02/L-33
- Ligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik - Nr. 02/L-67
- Kodi Penal<sup>9</sup> i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, 20 Prill 2012

#### 3.2. Aktet nënligjore

- Rregullorja për dhënie, përkatësisht marrjen e lejes të shoqatave për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, Nr. 01/2012
- Rregullorja për pajtueshmërinë me obligimet e të drejtës së autorit, Nr. ?, KPM,
- Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës për shërbyesit medial audio-vizual
- Rregullorja për Distribuim Kabllor për Programet Radio Televizive në Kosovë CIMC 2007/04

<sup>9</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, 20 Prill 2012, Neni 444, Hyrja në Fuqi 1 Janar, 2013.

- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2010, për zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-170 për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale

### 3.3. Legjislacioni Evropian dhe Ndërkombëtar

- Konventa e Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike të vitit 1886
- Konventa e Romës për mbrojtjen e përforcuesve, prodhuesve të fonogrameve dhe organizatave të transmetimit i vitit 1961
- Marrëveshja mbi Aspektet Tregtare të së Drejtës së Pronës Intelektuale (TRIPS), 15 prill 1994
- Rregullorja Nr. 2004/48 për zbatimin e të drejtave pronësore intelektuale;
- Direktiva 93/83/KEE datë 27 shtator 1993 “Për koordinimin e rregullave për të drejtën e autorit dhe të drejtave të përafërta që zbatohen në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kablore;
- Rregullorja e Këshillit Nr. 1383/2003 e 22 Korrikut 2003 ne lidhje me aksionet doganore kundër mallrave që dyshohet që shkelin të drejtat pronësore intelektuale të caktuara dhe masat që mund të merren kundër mallrave që shkelin këto të drejtat.
- Direktiva 2001/84/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 27 shtator 2001 “Për të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një vepre arti origjinale”
- Direktiva 2006/115/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 12 dhjetor 2006 “Për të drejtën e qirasë dhe huazimit si dhe për disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale”;
- Direktiva 2006/116/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 12 dhjetor 2006 “Për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtat e përafërta”
- Direktiva 96/9/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 11 mars 1996 “Për mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave”
- Direktiva 2009/24/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 23 prill 2009 “Për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike”
- Traktati i organizatës botërore të pronësisë intelektuale për përformimin dhe fonogramin, 20 maj 2002
- Konventa universale mbi të drejtat e autorit, 5 nëntor 1992
- Marrëveshja e organizatës botërore për të drejtat e autorit, 6 mars 2002
- Konventa për mbrojtjen e producentëve të fonogrameve kundër shumëzimit të paautorizuar të fonogrameve të tyre, 15 tetor 1996.

## 4. Mjetet juridike

### 4.1. Ligji mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

Me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta në Kosovë janë parashikuar masat administrative; inspektimi; mbrojtja juridiko-civil, të cilat zbatohen në përputhje me rregullat e përgjithshme të procedurës administrative dhe gjyqësore.

Kapitulli XII i Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në Kosovë, parasheh dispozitat ndëshkuese në rast të shkeljes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta. Në përgjithësi, në bazë nenit 177 të Ligjit mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, personit të cilit i janë shkelur të drejtat e tij/saj, mund të kërkojë mbrojtjen dhe gjithashtu të kërkojë kompensimin përkatës në bazë të rregullave të kompensimit. Mbrojtja e njëjtë mund të kërkohet edhe në rastet kur ekziston rreziku i dukshëm i shkeljes së këtyre të drejtave.

Titullari i së drejtës së autorit në rast të shkeljes së të drejtave mund të kërkojë:

- Lëshimin e një vendimi që ndalon vazhdimin e shkeljes dhe shkeljeve të përsëritura në të ardhmen;
- Kompensimin e dëmit material (dëmin aktual dhe fitimin e humbur);
- Kompensimin e dëmit jo-material të shkaktuar si rezultat i shkeljes së të drejtave morale;
- Shkatërrimin dhe largimin nga tregu i mallrave që krijohen si rezultat i shkeljeve të të drejtave të autorit. Në të njëjtën kohë mund të kërkohet dhe shkatërrimi i materialeve dhe mjeteve të përdorura për krijimin apo fabrikimin e këtyre mallrave.

#### 4.1.2. Dispozitat ndëshkuese

Sipas ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, ekziston dallimi në ndëshkimin e personave, varësisht nëse është person fizik apo juridik. Bazuar në nenin 190 të këtij Ligji, në rastet e shfrytëzimit pa leje të ndonjë veprë të autorit personi fizik do të dënohet prej 500 derë në 2.000 EUR, ndërsa personi juridik do të dënohet 2.000 deri në 10.000 EUR.

Për kryerje të veprimit të shmangies së masave teknologjike dhe për kryerje të veprimit të heqjes apo ndryshimit të informacionet elektronik të realizimit të të drejtave, personi juridik do të dënohet prej 5.000 deri në 25.000 EUR dhe personi fizik prej 1.000 deri në 5.000 EUR.<sup>10</sup>

---

<sup>10</sup> Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, neni 191

## 4.2. Kodi Penal i Kosovës

Në bazë të Kodit Penal,<sup>11</sup> shkelja e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërt të konsiderohet si vepër penale. Kodi Penal i Kosovës, në rast të cenimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, parasheh, konfiskimin e sendeve dhe pajisjeve me të cilat kryhet vepra.

Bazuar në nenin 296, cenimi i të drejtës së autorit përfshinë veprimet e më poshtme:

Kushdo që nën emrin e tij apo të dikujt tjetër, shfaq apo në ndonjë mënyrë tjetër i kumton publikut punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose paraqitjen e tjetrit, në tërësi apo pjesërisht, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

Kushdo që gjatë përdorimit të punës së mbrojtur me të drejtat e autorit ose paraqitjes së tjetrit, qëllimisht nuk cek emrin, pseudonimin ose shenjën e autorit apo të performuesit kur kjo kërkohet me ligj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.

Kushdo që e ndryshon, shtrembëron ose në ndonjë mënyrë tjetër e dëmton punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose paraqitjen e tjetrit, dhe e shfaq në atë formë ose në ndonjë mënyrë tjetër ia kumton në formë të tillë publikut, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Kushdo që paraqet ose në ndonjë formë tjetër ia kumton publikut në mënyrë të papërshtatshme punën e mbrojtur me të drejtën e autorit ose paraqitjen e tjetrit, që është paragjyquese për nderin dhe autoritetin e autorit ose performuesit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Kushdo që pa autorizim përdor punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose temën e çështjes së ndërlidhur me këto të drejta, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

Nëse gjatë kryerjes së veprës penale nga paragrafi 5. i këtij neni, kryesi ka përfituar për vete ose për personin tjetër së paku dhjetë mijë (10.000) Euro por më pak se pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.

Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 5. i këtij neni përfiton për vete ose për personin tjetër më shumë se pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tetë (8) vjet.

Parashihet që sendet dhe pajisjet për prodhimin e tyre nga ky nen konfiskohen.

Për më tepër, Kodi Penal i Kosovës parashikon edhe shmangien e masave teknologjike si vepër penale, me ç'rast konsiderohet që, personi ka kryer këtë vepër kur ka shmangur ndonjë prej masave efektive mbrojtëse të teknologjisë ose të heqjes apo ndryshimit të të

<sup>11</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, 20 Prill 2012, Neni 444, Hyrja në Fuqi 1 Janar, 2013.



drejtave elektronike për menaxhimin e të dhënave, siç parashihet në dispozitat e ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta. Kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet. Ndërsa sendet dhe pajisjet me të cilat është bërë shmangia konfiskohen.<sup>12</sup>

## 5. Rolet dhe Përgjegjësitë e Institucioneve

### 5.1. Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (ZDA) është organ administrativ në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i krijuar me rregulloren Nr. 01/2010 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, dhe funksionon në bazë të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

ZDA është institucioni kryesor dhe prijatar i institucioneve tjera që merren me të drejtat e autorit në Republikën e Kosovës. Roli i ZDA-së në mbrojtjen e të drejtave të autorit është i rëndësishëm edhe pse jo direkt, për faktin se është organi kryesor koordinues me institucionet tjera në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit.

Veprimtaria themelore e Zyrës përfshin: Dhënien e lejes shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave; marrjen e lejes së dhënë Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave në rast të mos përmbushjes së kriterëve të parapara me ligj; mbikëqyrjen e veprimtarisë dhe aktiviteteve të shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave; promovimin dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për dhënien e informatave të duhura autorëve, bartësve të të drejtave dhe opinionit të gjerë lidhur me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta; përcjelljen e legjislacionit ndërkombëtar dhe dhënien e rekomandimeve përkitazi me fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta.

ZDA bënë mbledhjen e informatave dhe të dhënave për gjendjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në nivel të vendit dhe monitorimin e zbatimit të konventave ndërkombëtare dhe marrëveshjeve reciproke e bënë Zyra, e cila harton edhe propozimet për plotësimin e legjislacionit dhe mekanizmave të zbatimit. Misioni, detyrat dhe angazhimet e ZDA-së, ndikojnë drejtpërsëdrejti në mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe në luftimin dhe uljen e shkallës së piraterisë në Republikën e Kosovës

<sup>12</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, 20 Prill 2012, Neni 297

## 5.2. Inspektorati i Tregut

Inspektorati i tregut është organ ekzekutiv i pavarur në kuadër të MTI-së, i themeluar në Ligjin “ Për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut “ , Nr 03/L-181, në bazë të të cilit ka kompetencë që të inspektojë dhe mbikëqyrë; standardet e tregtimit të mallrave dhe shërbimeve, të vendosura në tregun e brendshëm të Republikës së Kosovës.

Inspektorati i tregut ka për kompetencë për të kontrolluar rregullisht vendet e tregtimit, prodhimit, depot, vendet e punës dhe vendet tjera dhe për të siguruar se produktet apo shërbimet e vendosura në qarkullim nuk i cenojnë praktikën e mira afariste, nuk i dëmtojnë interesat e konsumatoreve dhe nuk janë në kundërshtim me praktikën e mira tregtare dhe mund të luaj rol të caktuar në luftimin, parandalimin e shkeljeve të drejtave të pronës intelektuale.

Inspektorati i tregut deri me tani nuk ka pasur ndonjë trajnim lidhur me zbatimin e të drejtave të pronës intelektuale prandaj çdo veprim i tij në treg duhet që paraprakisht të organizohen trajnime specifike në fushën e pronës intelektuale.

## 5.3. Policia e Kosovës

Çështja e mbrojtjes së të drejtave të autorit hynë në kuadër të veprave penale kundër Ekonomisë, ku roli i Policisë së Kosovës është i një rëndësie të veçantë. Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit si bazë ligjore kundër këtyre veprave e konsideron nenin 296 “Cenimi i të Drejtave të Autorit” si dhe Sektori i hetimeve të Krimeve Kibernetike në kuadër DKKO, bazuar në Ligjin mbi Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetikë Nr. 03/1-166, mund t’i trajtoj, gjegjësisht, hetoj format e Cenimit të Drejtave të Autorit përmes Teknologjisë Informative. Të gjitha këto veprime, bëhen në koordinim me prokurorinë përkatëse bazuar në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

Përveç këtyre veprimeve DHKEK, ka mandat që të koordinoj aktivitetet me institucione tjera të zbatimit të ligjit siç janë: Dogana e Kosovës, ATK, FIC, ZPI, ZDA e institucioneve tjera me qëllim të hetimit dhe parandalimit të këtyre aktiviteteve penale.

Nevojat për ngritjen e kapaciteteve profesionale në Policinë e Kosovës-DHKEK (Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit), në fushën e të Drejtës së Autorit më së shumti janë të nevojshme trajnimet, seminarët (e sidomos trajnime nga përvojat ndërkombëtare) ku pjesë e këtyre trajnimeve dhe seminareve të jenë edhe prokuror, gjykatës, doganier, Inspektorë të ATK-së si dhe personel nga Institucionet tjera që e trajtojnë të Drejtën e Autorit.

DHKEK-ut është pjesë edhe e Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtjen e Pronës Intelektuale 2010-2014, Planit të veprimit, si dhe pjesë e Këshillit Shtetëror të Mbrojtjes së Pronës Intelektuale.

#### 5.4. Dogana e Kosovës

Dogana e Kosovës në kuadër të misionit fiskal, ekonomik dhe mbrojtjes, përmes instrumenteve ligjore ka për detyre edhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, me qëllim të mbrojtjes së biznesit legal nga konkurrenca e pandershme.

Në vitin 2010 Sektori I DPI-së/Dogana e Kosovës është kompletuar me kornizën ligjore, e që është në përputhje me marrëveshjen TRIPS dhe Rregulloren e KE 1383. Me ligjin mbi Masat Doganore për Mbrojtje të Pronësisë Intelektuale (03-L/170/2010) është bërë rregullimi i procedurave për mallrat e dyshimta që shkelin të drejtën pronësore intelektuale, të cilat janë deklaruar për qarkullim të lirë, eksport ose ri-eksport, ose që janë gjetur gjatë kontrollit të mallrave duke hyre ose duke dalë nga territori i Doganave të Republikës së Kosovës, të vendosura nën procedurën e transitit, procedurat e magazinimit Doganor, procedurave të përpunimit të brendshëm, përpunimi nën mbikëqyrjen Doganore, importit të përkohshëm, të vendosur në zonë të lirë, në depo të lirë doganore në pajtim me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Aktualisht, bazuar në ligjin për masat doganore për mbrojtje të të drejtës së pronësisë intelektuale, në rastet kur dyshohet se cenohet e drejta e pronësisë intelektuale, autoritetet doganore kanë kompetenca të:

- reagojnë nëpërmjet kërkesës për veprim të bartësit të të drejtave;
- reagojnë edhe ex-officio;
- ndërmarrin ndalimin e mallrave;
- zbatojnë masa të përkohshme në rastet kur zotëruesi i të drejtës mund të vërtetojë shkeljen e të drejtave të PI-së;
- shkatërrojë mallrat e pirate dhe të falsifikuara;

Gjithashtu, ligji 03-L/170/2010 dhe UA 07/2010 rregullon edhe procedurën e aplikimit për kërkesën për veprim. Kërkesa e depozituar, do të shqyrtohet nga autoriteti doganor dhe brenda afatit ligjor prej 30 ditëve do të aprovohet e cila do të jetë e vlefshme për një vit me mundësi të vazhdimit të afatit, apo do të refuzohet nëse nuk i përmban gjitha informatat sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Bazuar në Kornizën Operative Strategjike (KOS) 2011-2014 të Doganës së Kosovës, Sektori i DPI-së ka hartuar Planin e Veprimit 2012, në të cilin janë përcaktuar objektivat kryesore dhe detyrat për kontrollin dhe zbatimin efikas për mbrojtje të pronësisë intelektuale.

#### 5.5. Zyra për Pronësi Industriale

Zyra për Pronësi Industriale luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe administrimin e të drejtave pronësore intelektuale në vend. Karshi mbrojtjes së të drejtave të autorit, ZPI është e angazhuar në mënyrë indirekte. Kjo për faktin që bazuar në Ligjin mbi Patentat, me të cilin është themeluar kjo zyrë, ZPI është më përgjegjëse në mënyrë specifike për regjistrimin dhe administrimin e të drejtave pronësore industriale.

Ndërsa në bazë të vendimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është themeluar Këshilli Kombëtarë për Pronësi Intelektuale, ku ZPI është caktuar të jetë udhëheqëse e këtij këshilli dhe kontribuon përmes dhënies së rekomandimeve dhe organizimit të takimeve, debateve, forumeve në lidhje me të drejtat pronësore në vend.

ZPI po ashtu ndihmon në mbrojtjen e të drejtave të autorit përmes shkëmbimit të përvojave me ZDA në lidhje me produktet e falsifikuara të vendosura në treg si dhe përmes aprovimit të strategjive për të drejtat pronësore intelektuale në nivel shtetëror.

ZPI ka një staf të kualifikuar, sidoqoftë meqenëse të drejtat e autorit janë pak më ndryshe nga të drejtat pronësore industriale, stafi i ZPI-së ka nevojë që të merr pjesë në trajnime të ndryshme që kanë të bëjnë me vendosjen e produkteve të falsifikuara në treg, sidomos të atyre që mbrohen me të drejtat e autorit.

## 5.6. Ministria e Drejtësisë

Roli i Ministrisë së Drejtësisë është që të implementoj legjislacionin në fuqi dhe politikat e Qeverisë në fushën e drejtësisë, duke përfshirë këtu hartimin dhe ndjekjen e politikave në këtë fushë, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e funksioneve të tjera që për qëllim final kanë sundimin e rendit dhe ligjit.

Ministria e Drejtësisë me dispozitat e Kodit Penal ka sanksionuar veprimet që cenojnë apo shkelin të drejtën e autorit si vepra penale.

Në bashkëpunim me ZDA-në, Ministria e Drejtësisë do të ndihmojë në fushatën vetëdijesuese lidhur me të drejtat të autorit dhe të drejtat e përafërta duke trajnuar zyrtaret e saj si dhe forma tjera që mbështesin ndërgjegjësimin.

## 5.7. Oda Ekonomike e Kosovës

Oda Ekonomike e Kosovës, është organizatë profesionale jofitimprurëse dhe subjekt juridik i pavarur, i themeluar me ligj Nr. 2004/7. Oda Ekonomike e Kosovës, ka një rol kyç në edukimin e bizneseve në çështjet e të drejtave të autorit. Vetëdijësimi i bizneseve në këto çështje janë pikat kryesore të strategjisë për luftimin e piraterisë dhe falsifikimit. Sa më i lartë të jetë informimi i bizneseve në përgjithësi për rëndësinë dhe rolin e të drejtave të autorit, aq më i ulët do të jetë niveli i piraterisë dhe falsifikimit.

Po ashtu, Oda Ekonomike e Kosovës ka bashkëpunim me organet e pushtetit në formulimin e strategjive të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, përmirësimin e infrastrukturës ekonomike dhe në lëmin e politikës ekonomike mbrojtëse.

Është e rëndësishme që bizneset të kontribuojë të paktën me anë të aktiviteteve të tyre organizative, në mënyrë që institucionet që synojnë të përmirësojnë situatën në fushën e pajtimit dhe zbatimit të të drejtave të autorit të kenë mbështetje dhe bashkëpunim afatgjatë dhe aktiv.

Këto biznese duhet të përfshihen në aktivitetet edukative në varësi të përshkrimit të tyre të punës. Veçanërisht, sipas Ligji 2004/7, Oda Ekonomike e Kosovës i promovon në mënyrë aktive të drejtat e autorit, duke i mbrojtur përmes lëshimit të bar-kodeve, dhe dhënies së certifikatave për origjinën e mallit.

## 5.8. Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë

Ministria e Arsimit ka një rol kyç në edukimin qytetarë në çështjet e të drejtave autorit. Vetëdijesimi i publikut si dhe arsimimi në këto çështje janë ndër shtyllat kryesore të strategjisë për luftimin e piraterisë dhe falsifikimit. Sa më i lartë të jetë informimi i qytetarit në përgjithësi për rëndësinë dhe rolin e të drejtave të autorit, aq më i ulët do të jetë niveli i piraterisë dhe falsifikimit.

Sipas kësaj strategjie, roli i Ministrisë së Arsimit do të fokusohet në dy drejtime:

1. Edukimi i nxënësve, studentëve dhe mësuesve për çështjet e të drejtave të autorit.
2. Përshtatja e kurrikulave mësimore në të gjitha nivelet e arsimimit, duke përfshirë në to temat-mësimet mbi të drejtat e autorit – këto aktivitete parashihet të zbatohen në afat të gjatë, dhe ku divizioni për hartimin e kurrikulave ka një rol kyç;

### 1. Vetëdijesimi

Fushatat e vetëdijesimit që kjo strategji propozon duhet të plotësohen me masa arsimore në secilin nivel shkollor:

**Arsimi i mesëm i ulët:** Fushata periodike ndërgjegjësimit, nxënësve parashihet t'u transmetohen informacione dhe mesazhe të qarta lidhur me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta përmes aktiviteteve të ndryshme.

**Arsim i mesëm i lartë:** Edukata qytetare është njëra nga lëndët përmes të cilave do t'u mundësohej konsolidimi i njohurive arsimore që fokusohen në shkeljet e të drejtës së autorit, piraterisë dhe falsifikimit (në muzikë-audio dhe video, video lojëra etj.) dhe ndëshkimin e tyre.

### 2. Kurrikulat

Arsimimi në konceptin e përgjithshëm ndërdisiplinor të mbrojtjes së pronësisë intelektuale duhet të mundësojë administrim cilësor, jo vetëm për sektorin e biznesit por edhe për të gjitha nivelet e pushtetit, lokal dhe qendror. Theks i veçantë duhet t'i jepet studimit në universitete, institucione gjyqësore dhe një numër institucioneve të tjera aktive në promovimin e të drejtave të këtij lloji. Mësimi dhe studimi universitar në këtë fushë mund të japë një kontribut të rëndësishëm në krijimin energjive dhe zhvillimin e ekonomik, të dijes, jo vetëm në nivel shtetëror, por edhe evropian dhe ndërkombëtar.

Është e rekomandueshme që arsimimi në fushën e Pronës Intelektuale të jetë i lidhur ngushtë me arsimimin për përgjegjësinë dhe edukatën qytetare. Kështu kurrikula duhet të mbulojë për shembull temat e mëposhtme: Përgjegjësia dhe obligimi qytetar për të

kontribuar në mbrojtjen e të Drejtave të autorit; Përgjegjësia morale dhe ligjore për të raportuar rastet e abuzimit, vjedhjes, deformimit ose kopjimit të veprave, risive dhe të drejtave të pronësisë intelektuale të autorëve tjerë, qofshin këta kosovarë apo të huaj; E drejta për t'iu drejtuar institucioneve relevante me qëllim raportimin e rasteve të shkeljeve të të Drejtave të Autorit.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të shikojë me përparësi krijimin e kurrikulave specifike, si dhe ti inkurajojë drejtimet relevante në UP, si në Fakultetin Ekonomik, Fakultetin Juridik, etj. Gjithashtu e rëndësishme është që këto kurrikula të adoptohen edhe nga bartësit privat të studimeve universitare.

Hartimi i këtyre kurrikulave dhe zbatimi i tyre duhet të koordinohet me Zyrën për të Drejtat e Autorit, nën përgjegjësinë e përgjithshme të MASHT-it. Gjithashtu, rekomandohet që për hartimin dhe miratimin e saktë të futjes së njohurive përkatëse në kurrikula, të shfrytëzohet eksperiencia e Divizionit për Hartimin e Kurrikulave në MASHT.

### **5.9. Universiteti i Prishtinës**

Universiteti i Prishtinës, përmes Fakultetit Juridik, do të vazhdojë me programin e masterit për të drejtat pronësore intelektuale. Gjithsesi, Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Juridik, do të punojë drejt krijimit të kurrikulës së lëndës e Drejta e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, si dhe duke e inkorporuar këtë lëndë në nivelin e studimeve themelore.

Gjatë kësaj kohe do të punohet në avancimin dhe afrimin të stafit të kualifikuar për të ligjëruar këtë lëndë. Për më tepër, do të kërkohet ndihmë nga organizatat dhe institucionet relevante ndërkombëtare.

Universitetet publike dhe bartësit privat duhet të adoptojnë gradualisht mundësi për studime pasuniversitare si dhe doktoratura në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale.

### **5.10. Komisioni i Pavarur për Media**

Roli i Komisionit të Pavarur për Media (KPM) është i përcaktuar me Ligjin për KPM-në Nr. 04/L-44. Në bazë të këtij Ligji roli i KPM-së konsiston në promovimin dhe zhvillimin e një tregu të shëndoshë të shërbimeve mediale audio-vizuale që u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Pa dyshim që promovimi dhe zhvillimi i tregut të shëndosh medail në Republikën e Kosovës është i lidhur ngushtë me krijimin e një ambienti të sigurt dhe të qëndrueshëm për transmetuesit në Kosove, duke i siguruar këta të fundit që të drejtat e tyre të transmetimit apo të ritransmetimit do të respektohen.

Prandaj, KPM me qëllim të sigurimit së shërbimet mediale audio-vizuale veprojnë në pajtim me të drejtën e autorit, ka nxjerre disa akte nënligjore për t'i parandaluar shkeljet eventuale të së drejtës së autorit, gjegjësisht të drejtës për ri-transmetim.

Aktet nënligjore të miratuar nga KPM lidhur me fushën e të drejtës për ri-transmetim:

- a. Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës për Televizione
- b. Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës për Operator Kabllor
- c. Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës për Ofrues të Shërbimeve Programore
- d. Rregullorja për Distribucion Kabllor për Programet Radio Televizive në Kosovë
- e. Rregullorja për pajtueshmërinë me obligimet e të drejtës së autorit

Të gjitha aktet e lartpërmendura janë në funksion të mbrojtjes të së drejtës së ri-transmetimit në media elektronike në Kosovë, gjegjësisht në funksion të promovimit dhe zhvillimit të një tregu të shendosh medial, funksion ky i paraparë edhe me ligjin për KPM-në.

Shërbyesit medial audio-vizual në momentin e marrjes së licencës nga KPM për të operuar brenda territorit të Kosovës, janë të obliguar që t'i përmbahen të drejtë së autorit, obligim të cilin e marrin me në momentin e licencimit. Shërbyesit media audio-vizual gjatë veprimtari së tyre duhet t'i nënshtrohen Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërt si dhe akteve nënligjore të KPM-së.

Të gjithë të licencuarit e KPM-së, janë të obliguar që ta njoftojnë paraprakisht KPM-në para ri-transmetimit të programeve së posedojnë marrëveshjet valide për ri-transmetim dhe të njëjtat t'i deponojnë në KPM. Një rregull i tillë është paraparë si një formë e pranuar me qëllim të parandalimit të shkeljes gjegjësisht keqpërdorimit të së drejtës së autorit.

KPM gjatë mandatit të saj ka proceduar raste të shumta lidhur me shkeljen e së drejtës për ri-transmetim nga ana e shërbimeve mediale audio-vizuale. Këto raste varësisht nga natyra dhe lloj i shkeljeve janë proceduar në pajtim me ligjin për KPM-në, ku një numër jo i vogël i tyre është proceduar për sanksionim më gjobë.

E gjithë procedura e zhvilluar nga ana e KPM-së në drejtim të mbrojtjes së të drejtës për ri-transmetim është e karakterit administrativ, që konsiston në sigurimin e asaj së të licencuarit e KPM-së, veprojnë në pajtim me kushtet dhe termet teknike të vendosura nga KPM më qëllim të promovimit të një tregu të shendosh medial në Republikën e Kosovës.

### 5.11. Shoqatat për Administrim Kolektiv

Shoqatat për administrimin kolektiv përveç që bëjnë administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, në të njëjtën kohë janë një nga kontribuuesit e mëdhenj të informatave për keqpërdorimin e të drejtave të autorit si dhe kompletimin e informatave në lidhje me shkelësit me të mëdhenj të të drejtave të autorit

dhe të drejtave të përafërta.

Duke qenë në kontakt të përhershëm me konsumatorët, dhe autorët e veprave të mbrojtura, Shoqatat për administrimin Kolektiv, do të kenë informata me të sakta në lidhje me shkelësit dhe prodhuesit e piraterisë. Këto të dhëna ata do ti ndajnë me Zyrën e të Drejtave të Autorit dhe rrjedhimisht me Task Forcën e krijuar për të luftuar këtë dukuri.

Po ashtu, shoqatat e krijuara nga vetë krijuesit kanë informata të dorës së parë në lidhje me të drejtat e tjetërsuara, apo të përfaqësuara dhe do të jenë në gjendje me saktë të identifikojnë lejet dhe kontratat e dhëna për të drejtat e autorit, apo falsifikimin e këtyre lejeve. Kontribuuesit kryesore do të jenë edhe vetë autorët të cilët do të raportojnë shkeljen e të drejtave të tyre tek shoqatat përkatëse dhe adresën e sakte të ri-shitësit "pirat".

Shoqatat mbrojnë edhe të drejtën e autoreve të huaj, si dhe shtëpive filmike apo disko-grafike të huaja, këto shtëpi filmike apo disko-grafike do të regjistrojnë veprat e veta në këto shoqata, dhe për ç'fare këto shoqata në mënyre automatike do të menaxhojnë në mënyre kolektive të drejtat e këtyre autoreve të huaj.

## **6. Qëllimi, objektivat dhe aktivitetet e strategjisë**

### **6.1. Qëllimi**

Qeveria e Kosovës me këtë strategji synon të luftoj piraterinë dhe falsifikimin në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në Kosovë. Qëllimi kryesorë i strategjisë është krijimi i mekanizmave për të luftuar këto dukuri negative përmes gjetjes së rrugëve dhe metodave adekuate, që do të ndikonin pozitivisht në imazhin dhe ekonominë e vendit tonë. Kjo strategji synon ndërlidhjen e të gjithë faktorëve relevant në mënyrë që të veprohet drejt realizimit me sukses të këtij qëllimi.

Dhënia e rekomandimeve në favor të plotësisht dhe harmonizimit të bazës ligjore ekzistuese, identifikimi i problemeve, shkaqeve e faktorëve që ndikojnë në ekzistimin dhe rritjen e piraterisë dhe falsifikimit është një ndër qëllimet kyçe të kësaj strategjie.

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve dhe komunitetit të biznesit për të drejtat e autorit dhe të drejtave të përafërta; për të luftuar falsifikimin dhe piraterinë më efektivisht si dhe për të mbrojtur publikun ndaj kërcënimit, do të përcaktohen format për informimin e qytetarëve në lidhje me procedurat dhe veprimet që do të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse.

### **6.2. Objektivat**

Grupi Punues ka përcaktuar objektivat kryesore të kësaj strategjie, me qëllim të luftimit të piraterisë dhe falsifikimit. Objektiva këto, të cilat rrjedhin si rezultat i obligimeve



ligjore vendore dhe atyre ndërkombëtare, Raportit të Progresit të Komisionit Evropian dhe përcaktimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për përafrimin e legjislacionit vendor me Acquis të BE-së. Konform realizimit këtyre obligimeve, kjo strategji synon të realizoj këto objektiva:

1. Ulja e nivelit të piraterisë dhe falsifikimit;
2. Rritja e produktivitetit në industrinë kreative;
3. Identifikimi i problemeve dhe shkaqeve që ndikojnë në rritjen e piraterisë dhe falsifikimit;
4. Luftimin e ekonomisë joformale dhe krijimi i parakushteve për investime të huaja;
5. Bashkëpunimi ndërinstitucional në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar;
6. Arritja e standardeve evropiane.

### 6.3. Aktivitetet dhe Alternativat e konsideruara

Për përmbushjen e objektivave strategjike, më qëllim të zbatimit të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, përkatësisht, luftës kundër piraterisë dhe falsifikimit, grupi punues ka paraparë ndërmarrjen e aktiviteteve të veçanta dhe konkrete për secilën objektivë.

Aktivitetet e parapara për përmbushjen e strategjisë janë si vijon:

- Plotësimi dhe zbatimi i legjislacionit aktual, fuqizimi i institucioneve përgjegjëse dhe
- Krijimi i institucioneve të tjera të nevojshme
- Krijimi i mekanizmave institucional dhe funksionalizimi i atyre ekzistues
- Identifikimi i produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit
- Krijimi i sistemit të menaxhimit të informacionit nga institucionet përgjegjëse
- Sensibilizimi i opinionit me të drejtat e autorit, organizimi i fushatave senzibilizuese, seminare, konferenca, kampanja në aspektin edukativ dhe atë penalo-juridik
- Konfiskimi i materialeve pirate dhe të falsifikuara;
- Sekuestrimi e materialeve të dyshuara për shkelje të drejtës së autorit;
- Konfiskimi i mjeteve të cilat janë përdorur për prodhimin e mallrave pirate dhe të falsifikuara,
- Pamundësimi i funksionimit të Web faqeve me përmbajtje pirate,
- Vënia në funksion e mjeteve juridike për pengimin e veprimtarisë pirate, mbrojtjen e veprave origjinale dhe ndëshkimin e kryerësve;
- Organizimi i anketave dhe hulumtimeve
- Përpilimi i raporteve në bashkëpunim me organet e rendit dhe drejtësisë respektimin e të drejtës së autorit

- Pajisja me etiketa/bar-kode e produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit,
- Pajisja me autorizime të prodhuesve për pikat e shitjes të produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit, me rastin e regjistrimit të bizneseve
- Parandalimi i krimit të organizuar në fushën e piraterisë dhe falsifikimit;
- Rregullimi i procedurave të vënies së produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit në treg
- Takime të rregullta të Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale
- Themelimi i Task Forcës;
- Shkëmbim më i shpeshtë i informatave
- Nënshkrim i marrëveshjeve të mirëkuptimit me institucionet përkatëse
- Anëtarësim i organizatave ndërkombëtare;
- Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe regjionale;
- Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit rajonal;
- Shkëmbimi i përvojave me vendet e rajonit;
- Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit vendor me atë Evropian;
- Ndërmarrja e veprimeve dhe arritja e rezultateve konkrete në luftën kundër falsifikimit dhe piraterisë;
- Aplikimi i përvojave dhe metodave më efikase të përafërta nga rajoni në luftën kundër falsifikimit dhe piraterisë;

Strategjia parash realizimin e secilit aktivitet të paraparë, me qëllim të arritjes së objektivave strategjike. Këto aktivitete të strategjisë do të realizohen, në periudhat kohore dhe nga institucionet relevante kompetente të parapara me Planin e Veprimit.<sup>13</sup> Aktivitet e kësaj strategjie do të realizohen në bashkëpunim të plotë ndërinstitucional, me bashkëpunim rajonal dhe në partneritet me institucionet relevante ndërkombëtare. Aktivitet strategjike, do të zbatohen nën mbikëqyrjen e ZDA-së, në bashkëpunim me institucionet implementuese të përfshira, konform përcaktimeve në Planin e Veprimit.

## 7. Qasja e rekomanduar dhe hapat e ardhshëm për zbatimin e strategjisë

### 7.1. Qasja e Rekomanduar

Hartimi i strategjisë, përcaktimi i objektivave është bërë duke konsideruar të gjithë faktorët relevant. Në këtë drejtim, janë marrë për bazë mundësitë buxhetore, kapacitetet personale dhe profesionale të institucioneve implementuese të kësaj strategjie. Kështu grupi është përcaktuar për zgjidhjet e ofruara në kuadër të aktiviteteve të parapara për implementimin e kësaj strategjie, konform legjislacionit dhe institucioneve ekzistuese, si dhe ndryshimeve eventuale në dy kategoritë e përmendura.

Për më tepër, ky grup është përcaktuar për objektivat dhe aktivitet pas hulumtimit, gjegjësisht takimeve që ka pasur me krijues të sferave të ndryshme të artit, shkencës, muzikës, por edhe me prodhues të produkteve kreative të cilët janë duke pësuar,

<sup>13</sup> Shih Planin I Veprimit për Zbatimin e Strategjisë

ekonomikisht dhe profesionalisht nga falsifikimi dhe pirateria.

Implementimi i aktiviteteve të përcaktuara ka implikime financiare, të cilat janë në detaje të përcaktuara në kuadër të Planit të Veprimit.<sup>14</sup> Mirëpo, implementimi i strategjisë sjellë përfitime në rrafshin shtetëror dhe atë privat. Në rrafshin shtetëror, luftimi i falsifikimit dhe piraterisë, ndikon në përmirësimin e imazhit të Kosovës, përkatësisht, plotësimit të të gjeturave në raportin e progresit të Komisionit Evropian. Në anën tjetër, në rrafshin privat ndikon në rritjen e të hyrave dhe nxitjen e veprimtarisë krijuese.

Mos veprimi dhe mos implementimi i strategjisë, rrezikon funksionalizimin e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta dhe krijon përshtypjen reale, të mos intervenimit shtetëror, kundër një veprimtarie e dëmshme.

Kjo strategji në pjesën e objektivave dhe aktiviteteve, përcakton masat konkret edhe veprimet në detaje institucioneve implementuese, përkatësisht përcaktohen edhe periudhat kohore të zbatimit të tyre.

Grupi për hartimin e Strategjisë, ka arritur në përfundim, se mekanizmat institucional për zbatimin e legjislacionit në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, me qëllim të luftimit më efikas dhe ndërmarrjes së masave me të shpejta kundër falsifikimit dhe piraterisë, duhet të organizohen në kuadër të një Task Force, të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Për këtë arsye, ky grup, i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës, të themelojë Task Forcën për luftimin e Falsifikimit dhe Piraterisë.

Themelimi i kësaj Task Force, është i domosdoshëm për rrethanat ekzistuese, si është cekur më lartë, këto dukuri janë në fazë të lartë të zhvillimit dhe shumë të dëmshme. Grupi Punues, ka parasysh se shkeljet në fushën e të drejtës së autorit, janë objekt i procedurave civile gjyqësore, përkatësisht padive private.

## 7.2. Misioni i Task Forcës

Grupi rekomandon intervenim shtetërorë të koordinuar në kuadër të një Task Force, duke u bazuar në intensitetin dhe dëmet e këtyre dukurive ku luftimi përmes padive private do të jetë shumë i vështirë. Për më tepër intervenimi shtetëror është obligim ligjor, duke marrë për bazë Kodin Penal të Republikës së Kosovës, i cili inkriminon, konkretisht sanksionon shkeljet e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, si dhe shmangien e masave teknologjike, për të cilat shkelje parashihen sanksione penale dhe procedura duhet iniciuar zyrtarisht.

Task Forca kundër falsifikimit dhe piraterisë është një organ i cili merret me adresimin e çështjeve në lidhje me luftën kundër shkeljeve të të drejtës së autorit, me hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit kundër piraterisë dhe falsifikimit, si dhe me organizimin dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete kundër piraterisë.

<sup>14</sup> Shih Planin I Veprimit për Zbatimin e Strategjisë

Task Forca përfshin organet kompetente publike që punojnë në fushën e të drejtës së autorit dhe në mbrojtjen e saj, si dhe aktorët e tregut dhe përfaqësuesit e organizatave të interesave ekonomike dhe sociale të përfshira në mbrojtjen e të drejtës së autorit.

Misioni i Task Forcës do të jetë si vijon:

- Promovimi i bashkëpunimit efektiv midis organeve publike dhe organizatave shoqërore dhe ekonomike të interesit në fushën e mbrojtjes së të drejtës së autorit;
- Zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit kundër falsifikimit dhe piraterisë, dhe koordinimi i zbatimit të tyre;
- Ndërmarrja dhe zbatimi i ndërgjegjësimit publik përmes fushatave informuese dhe programeve, në shërbim të trajnimit të punonjësve të organeve të zbatimit të ligjit dhe organeve gjyqësore të përfshira në luftën kundër falsifikimit dhe piraterisë;
- Përgatitja dhe ofrimi i propozimeve për procesin e hartimit të legjislacionit që lidhen me zbatimin e të drejtave të autorit.

## 8. Plani i Veprimit dhe objektivat

### 8.1. Realizimi

Plani i veprimit për implementimin e strategjisë, është paraparë të realizohet në periudha kohore të caktuara, varësisht nga objektiva përkatëse dhe institucionet implementuese.

Grupi ka paraparë aktivitetet dhe institucionet përgjegjëse për implementimin e tyre në afatet kohore të caktuara, si dhe indikatorët konkret që paraqesin arritshmërinë e aktiviteteve.

Periudha kohore për realizimin e aktiviteteve është caktuar të jetë nga viti 2012 deri në 2014, pra periudha implementuese trevjeçare. Grupi Punues me anë të këtij Plani të Veprimit, është përcaktuar për periudhën implementuese trevjeçare (2012-2014), dhe ka paraparë që në fund të kësaj periudhe kohore të përcaktohen aktivitetet për periudhën kohore 2015-2017, varësisht nga gjendja e zbatimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përfaqësuesve, dhe nga suksesi i luftimit të dukurisë së piraterisë dhe falsifikimit.

### 8.2. Objektiva 1: Ulja e nivelit të piraterisë dhe falsifikimit

IMPLEMENTIMI	
--------------	--

Objektiva	Aktiviteti	Institucionet Përgjegjëse	Korniza Kohore	Buxheti	Indikatorët
1.1 Ulja e nivelit të piraterisë dhe falsifikimit.	1. Fuqizimi i institucioneve përgjegjëse dhe ngritja e kapaciteteve	MPB/PK, MF/DK, MD, KGJK, KPK, MTI/IT, MASHT, MKRS/ZDA	2013	15,000.00 €	Rekrutimi dhe trajnimi i stafit
	1. Zbatimi dhe plotësimi i legjislacionit në fuqi	MKRS/ZDA, MF/DK, KGJK, MTI/IT, MPB/PK, MF/ATK, MTI/ZPI	2012-2014	15,000.00 €	Nxjerrja e akteve nënligjore,
	2. Krijimi i mekanizmave institucional dhe funksionalizimi i atyre ekzistues	ZKM, MKRS/ZDA, MPB/PK,	2012-2013	30,000.00 €	Themelimi i Task Forcës dhe ngritja e efikasitetit të institucioneve përgjegjëse
	3. Identifikimi i produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit	MF/ATK, MTI/IT, OEK, MF/DK, MTI/ZPI	2012-2014	//	Regjistrimi i produkteve pranë institucioneve përkatëse
	4. Sensibilizimi i opinionit me të drejtat e autorit, organizimi i fushatave senzibilizuese, seminare, konferenca, kampanja në aspektin edukativ dhe atë penalo-juridik	MKRS/ZDA, MTI/ZPI, MASHT, UP,	2012-2013	50,000.00 €	Organizimi i seminareve, konferencave, kampanjave në aspektin edukativ dhe atë penalo-juridik

### 8.3. Objektiva 2: Rritja e produktivitetit në industrinë kreative

IMPLEMENTIMI					
Objektiva	Aktiviteti	Institucionet Përgjegjëse	Korniza Kohore	Buxheti	Indikatorët
2.1 Rritja e produktivitetit në industrinë kreative.	- Konfiskimi i materialeve pirate dhe të falsifikuara;	MPB/PK, MF/DK, MTI/IT,	2013-2014	//	Zvogëlimi i sasisë së materialeve pirate në treg

- Sekuestrimi i materialeve të dyshuara për shkelje të drejtës së autorit;	MPB/PK, MF/DK, MTI/IT,	2013-2014	//	Zvogëlimi i sasisë së materialeve pirate në treg
- Konfiskimi i mjeteve të cilat janë përdorur për prodhimin e mallrave pirate dhe të falsifikuara,	MPB/PK,	2013-2014	//	Zvogëlimi i sasisë së mjeteve për prodhimin e mallrave pirate në treg
- Pamundësimin e funksionimit të Ëeb faqeve me përmbajtje pirate,	ART, ZDA	2013-2014	//	Zvogëlimi i numrit të Ëeb faqeve me përmbajtje pirate
- Vënia në funksion e mjeteve juridike për pengimin e veprimtarisë pirate, mbrojtjen e veprave origjinale dhe ndëshkimin e kryesve;	GJKATAT, MPB/PK,	2012-2014	//	Numër i theksuar i rasteve të shqyrtuara dhe ekzekutuara nga ana e organeve përgjegjëse

#### 8.4. Objektiva 3: Identifikimi i problemeve dhe shkaqeve që ndikojnë në rritjen e piraterisë dhe falsifikimit

IMPLEMENTIMI					
Objektiva	Aktiviteti	Institucionet Përgjegjëse	Korniza Kohore	Buxheti	Indikatorët
3.1. Identifikimi i problemeve dhe shkaqeve që ndikojnë në rritjen e piraterisë dhe falsifikimit.	- Organizimi i anketave dhe hulumtimeve	MKRS/ZDA,	2013	20,000.00 €	Publikimi i rezultateve të anketave dhe hulumtimeve
	- Përpilimi i raporteve në bashkëpunim me organet e rendit dhe drejtësisë në respektimin e të drejtës së autorit	MKRS/ZDA, MPB/PK, MD, MF/DK, MTI/IT, MF/ATK, KGJK, KPK,	2012-2014	5,000.00 €	Rritja e nivelit të bashkëpunimit dhe raportimit ndërinstinucional

	- Publikimi i rezultateve	MKRS/ZDA,	2013-2014	5,000.00 €	Paraqitja e gjendjes reale në fushën e të drejtës së autorit
--	---------------------------	-----------	-----------	------------	--

#### 8.5. Objektiva 4: Luftimin e ekonomisë joformale dhe krijimi i parakushteve për investime të huaja

IMPLEMENTIMI					
Objektiva	Aktiviteti	Institucionet Përgjegjëse	Korniza Kohore	Buxheti	Indikatorët
4.1 Luftimi i ekonomisë joformale dhe krijimi i parakushteve për investime të huaja.	- Pajisja me etiketa/bar-kode të produkteve të mbrojtura me të drejtën e autorit,	OEK,	2012-2014	//	Lehtësimi i identifikimit të produkteve pirate nga ato origjinale
	- Pajisja e pikave të shitjes me autorizime të prodhuesve për produktet e mbrojtura me të drejtën e autorit	//	2012-2014	//	Pajisja me autorizime të prodhuesit
	- Parandalimi i krimit të organizuar në fushën e piraterisë dhe falsifikimit;	MKRS/ZDA, MTI/ZPI, MF/DK, MF/ATK, MPB/PK, MTI/IT, OEK, MASHT, MD, GJYKATAT,	2012-2014	//	Ndëshkimi i shkelësve të drejtës së autorit
	- Rregullimi i procedurave të vënies së produkteve në treg të mbrojtura me të drejtën e autorit	MTI/IT,	2013	10,000.00 €	Miratimi të rregullores për vënien e produkteve kreative në treg

### 8.6. Objektiva 5: Bashkëpunimi ndërinstitucional në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar

IMPLEMENTIMI					
Objektiva	Aktiviteti	Institucionet Përgjegjëse	Korniza Kohore	Buxheti	Indikatorët
5.1 Bashkëpunimi ndërinstitucional në nivel nacional dhe ndërkombëtar	- Takimet e rregullta të Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale	ANËTARËT E KSHPI-së	2012-2014	//	Rezultatet e arritura nga takimet e rregullta të këshillit
	- Themelimi i Task Forcës;	ZKM	2012-2013	//	Vendimi/Rregullore për themelimin e Task Forcës
	- Shkëmbimi i informatave	MKRS/ZDA, MTI/ZPI, MTI/IT, MF/DK, MF/ATK, MPB/PK,	2012-2014	//	Njoftimi mbi zhvillimin e ngjarjeve në fushën e të drejtës së autorit në mes institucioneve që merren me këtë fushë
	- Nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit me institucionet përkatëse	MKRS/ZDA, MTI/ZPI, MTI/IT, MF/DK, MF/ATK, MPB/PK,	2012-2014	//	Ndarja e përgjegjësi në mes institucioneve përbërëse
	- Iniciativat për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare;	MKRS/ZDA, MTI/ZPI	2012-2014	10,000.00€	Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare
	- Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare dhe regjionale;	MKRS/ZDA, MTI/ZPI, MD, GJYKATAT, KPK, MPB/PK, MF/DK	2012-2014	15,000.00€	Fitimi i përvojave dhe krijimi i lidhjeve me vendet e rajonit dhe vendet tjera
	- Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit rajonal;	MKRS/ZDA, MTI/ZPI	2012-2014	10,000.00€	Rritja e efikasitetit në fushën e të drejtës së autorit
	- Shkëmbimi i përvojave me vendet e rajonit;	MKRS/ZDA, MTI/ZPI, MF/DK,MPB/PK	2013-2014	//	Lidhja e marrëveshjeve me vendet e rajonit në luftë kundër piraterisë dhe falsifikimit



## 8.7. Objektiva 6: Arritja e standardeve evropiane

IMPLEMENTIMI					
Objektiva	Aktiviteti	Institucionet Përgjegjëse	Korniza Kohore	Buxheti	Indikatorët
6.1 Arritja e standardeve evropiane.	- Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit vendor me atë Evropian;	MKRS/ZDA, MTI/IT, MF/DK, MPB/PK,	2013-2014	10,000.00€	Rishikimi i gjendjes aktuale në këtë aspekt
	- Ndërmarrja e veprimeve dhe arritja e rezultateve konkrete në luftën kundër falsifikimit dhe piraterisë;	MPB/PK, MTI/IT, MF/ATK, MF/DK, MKRS/ZDA,	2013-2014	//	Aksionet e organizuara dhe të ndërmarra nga Task Forca
	- Aplikimi i përvojave dhe metodave më efikase të përafërta me rajonin, në luftën kundër falsifikimit dhe piraterisë;	MPB/PK, MTI/IT, MF/ATK, MF/DK, MKRS/ZDA	2013-2014	//	Ndërmarrja e veprimeve në treg në pajtim me standardet evropiane dhe praktikatat e rajonit

195,000.00 €